



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.17/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit av. I.H., si përfaqësues i autorizuar i të paditurit – kundër propozuesit "M.....I..... " nga Prizreni me përfaqësues S.K., nga fsh. Gelance Komuna e Suharekës, ndaj gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Suhareke, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.92/2023, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.24.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit av. I.H., si përfaqësues i autorizuar i të paditurit- kundër propozuesit “M..... I.....” nga Prizreni me përfaqësues S.K., nga fsh. Celanee Komuna e Suharekës. ndaj gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Suharekë. Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjellien e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.92/2023.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës av. I.H., nga Gjakova, si përfaqësues i autorizuar i të paditurit kundër propozuesit "M..... I....." nga Prizreni me përfaqësues S.K., nga fsh. Gelance Komuna e Suharekës, me dt. 12.12.2024 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit Robert Tunqj. gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren — dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.92/2024.

Ankuesi në kërkesën e parashtruar, ka deklaruar se është përfaqësues i autorizuar i Kundër propozuesit NTSH "M..... I....."• nea Prizreni, me përfaqësues Sylejman Kurtishaj nga fshati Gelance Komuna e Suharekës në lëndën C.nr.92/2023 e cila lëndë është në rrjedhë e sipër. Gjykata Themelore në Suharekë me cit. I I .09.2024 me aktvendim ka caktuar masën e sigurisë e Cila është regjistruar në Drejtorinë Për Gjeodezi dhe Kadastër ne Suharekë. Gjykata e Apelit me dt.(06.I I .2024 ka marr aktvendim përmes së cilës ka aprovuar ankesën e kundër propozuesit dhe e ka prishur aktvendimin e Gjykatës Themelore ne Suharekë dhe e ka kthyer ne rigjykim. Duke pasur parasysh këtë fakt dhe momentin e shfuqizimit te vendimit ka cekur se i njëjti më nuk prodhon efekt juridik dhe me parashtrësë ka kërkuar nga gjykata qe në mënyrë urgjente të procedojë aktvendimin e lartcekur te Apelit në Drejtori Për Gjeodezi dhe Kadastër , ose të merr vendim të veçantë me të cilën do ta fuqizojë masën e caktuar e Cila më tani pa bazë juridike është regjistruar në regjistrat përkatëse. Meqenëse gjyqtari në këto rrethana nuk ka vepruar në kuadër të detyrave dhe kompetencave të cilat i ka sipas ligjit konsideron se gjyqtari ka vepruar në kundërshtim të dispozitave ligjore të Ligjit 06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe atë të nenit 5 q? ka të bëjë me Shkelje disiplinore te gjyqtarëve dhe nenit 40 të ligjit të lartcekur Për Detyrat e gjyqtarit si dhe bazuar ne nenin 309 par. I ku përcaktohet se "Masa e caktuar me vendim te gjykatës mbetet në fuqi deri sa të mos jepet vendimi tjetër mbi masën e sigurimit Këtë fakt nuk e ka respektuar gjyqtari i çështjes edhe pse ka pasur një vendim tjetër nga ana e gjykatës Së shkallës më te lartë , prandaj konsideron se gjyqtari ka shkelur ligjin deri sa lejon vendim i prishur të prodhoje efekt juridik dhe per këtë arsye kanë parashtruar kërkesë per inicim të procedurës disiplinore duke dyshuar në paanësinë e gjyqtarit dhe mosrespektim të detyrave të punës. Gjithashtu me këtë Kërkesë është kërkuar edhe përjashtimi i gjyqtarit R.T., nga kjo çështje Për shkak te dyshimit në paanësinë e gjyqtarit ne këtë çështje civile.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e Gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit R.T., gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren — dega ne Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.92/23 ka iniciuar hetimet preliminare per procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklarate nga gjyqtari i çështjes.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se në Gështjen civile C.nr.92/23 av. I.H., me autorizim e përfaqëson të paditurën NTPSH "M..... I....." ku Objekt kontesti është anulimi i marrëveshjes për ndërmjetësim dhe vërtetim të pronësisë . Me dt. 29.04.2024 gjykata ka caktuar masën e përkohshme dhe me dt. 11.09.2024 këtë masë e ka zëvendësuar me masë të sigurimit. ndaj këtij aktvendimi palët janë ankuar dhe Gjykata e Apelit me Aktvendim CA.nr. 1 153 1 /2024 e ka prish Aktvendimin C.nr.92/24 dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje. Pas kthimit në rivendosje gjykata ka caktuar seancën për shqyrtim te propozimit per masë me dl. 17.12.2024, por paraprakisht avokati Ilir Hoxha me parashtrësë të dt.27.1 1.2024 ka kërkuar gjykata të njoftojë Drejtorinë Për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Suharekës dhe te obligoj të shlyejë masën e sigurisë .Gjykata ka vlerësuar se kjo kërkesë është e parakohshme pasi që ende nuk është vendosur në mënyrë të plotfuqishmërisë për masën e sigurisë si dhe Gjykata e Apelit nuk ka vendosur për çështjen, por e ka kthyer gjykatës Së parë në rivendosje.

Andaj nga të lartë cekurat gjyqtari konsideron se pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të paditurit per shkelje disiplinore. per shkak të mos dërgimit të vendimit te apelit ne Drejtori për Kadastër dhe gjeodezi janë të pa baza , jo parimore dhe dashakeqe ndaj gjykatës. Gjithashtu ka

cekur se si gjyqtar i çështjes ne asnjë rrethanë dhe asnjë rast nuk ka trajtuar në mënyrë te pabarabartë palët në procedurë, në vendimmarrje ka qenë i paanshëm dhe i pa ndikuar ka vendosur në bazë të provave dhe në bazë të ligjit, dhe si e tillë ankesa është e pa bazuar dhe jo serioze.

Autoriteti kompetent Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari i çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës C.nr.92/2023.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme te provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore Prizren dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, në rrjedhë e sipër është padia e paditëses - propozueses Komuna e Suharekës të cilën e përfaqëso me autorizim Afrim Bytyqi, kundër të paditurve-kundërshtarëve te sigurimit NTSH"M..... I....." nga Prizreni te cilin me autorizim e përfaqëson avokati I.H., nga Gjakova dhe Sylejman Kurtishaj nga fshati Gelance Komuna e Suharekës , në çështjen për anulim te marrëveshjes për ndërmjetësimin dhe vërtetimit të pronësisë me propozim për caktimin e masës së sigurisë. Kjo lëndë i është caktuar gjyqtarit R.T., i cili i ka mbajtur disa shqyrtime per shqyrtimin e propozimit për masën e kërkuar të sigurisë dhe me dt.29.04.2024 ka caktuar masën e përkohshme të sigurisë te cilën e ka zëvendësuar me masën e sigurisë me dt. 1 1.09.2024. Ndaj këtij Aktvendimi ka parashtruar ankesë i autorizuari të zë paditurit. Gjykata e Apelit me Aktvendim te dt. CA.nr.1 153 1/2()24 e ka aprovuar si të themeltë ankesën dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Me shqyrtimin e te gjitha shkresave dhe posaqërisht me analizën e Aktvendimit te Gjykatës së Apelit CA.nr. 1 1 53 1/2024 me qëllim te vërtetimit te drejtë të pretendimeve të palës ankuese se gjyqtari i çështjes ka shkelur detyrat e punës duke mos e dërguar këtë aktvendim Drjetorisë së Kadastrit dhe Gjeodezisë në Suharekë, gjykata ka vërtetuar se është e vërtetë që Gjykata e Apelit ka vendosur në bazë të ankesës dhe e ka aprovuar si te themeltë , por nuk ka vendosur per masën e sigurisëdhe për çështjen per të cilën është parashtruar ankesa , ka vendosur që lëndën ta kthej në rigjykim dhe ne rivendosje në gjykatën e shkallës së parë tek gjyqtari i çështjes duke cekur vërejtjet dhe udhëzimet te cilat duhet të respektojë gjyqtari gjykues i shkallës së pare dhe pas këtyre vërejtjeve të rishqyrtojë edhe një here vendimin lidhur me masën e sigurisë. Masa e sigurisë caktohet që te sigurohet gjendja momentale e cila ka qenë kur është parashtruar padia per anulim të marrëveshjes se ndërmjetësimit dhe te çështjes së vërtetimit te pronësisë. Masa e sigurimit nuk e zgjidh çështjen në mënyrë meritore për te cilën është parashtruar padia, por ofron siguri per zhvillimin e rregullt te procedurës dhe për sigurim të drejtë të çështjes në mënyrë meritore. Gjykata e shkallës së dytë ka cekur në mënyrë decidive shkaqet te cilat konsideron se janë përfshirë në shkeljet e dispozitave procedurale dhe te cilat duhet të mirën parasysh nga ana e gjykatës së shkallës së parë gjatë rigjykimit dhe rivendujes , por nuk ka vendosur vet sipas detyrës per masën e sigurisë , per këtë vendim e ka obliguar dhe udhëzuar gjykatën e shkallës së pare pasi që të veprojë në bazë të udhëzimeve te percaktuara në aktvendim .Gjyqtari ka vepruar drejtë kur pas pranimit të Aktvendimit të Apelit e ka caktuar seancën në të cilën do te shqyrtohen udhëzimet sipas këtij aktvendimi dhe do te vendoset në lidhje me propozimin për masën e sigurisë.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtari R.T., në veprimet e tij nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura me lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 Për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

G.JYKATA THEMELORE PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr. 17/2024, me dt.24.12.2024



KËSHILLA JURI DIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.